THEATRI I YNE

I. CANKAR — F. DELAK

SHERBETORI JERNEJ

»PROGRES« 1949 PRISHTINË

THEATRII YNE

I. CANKAR — F. DELAK

SHERBETORI JERNEJ

»PROGRES« 1949 PRISHTINE

I. CANKAR — F. DELAK

SHERBETORI JERNEJ

Tirazhi: 1.000 coqë

Shtypë në mars të V. 1949 „PROGRES"

Personat:

SHERBTORI JERNEJ
GOSTAÇEV, student i ri
SITAR, zotnija i ri,
KRYETARI I KOMUNES
GJYKATSI
NEPUNSI MBRETNOR
PRIFTI
POLICET

HYMJE

(Skena hapet vetem 2 metra. Ne fund te skenes aji person pak i ndricuem, keshtu qe vetem sa mund te dallohet. Skena, si edhe vet salla e theatrit, jane plotesisht ne terr.)

PERSONI NE FUND TE SKENES: **Ndigjoni njerez!**

Kete tregim po u a tham, ashtu si ka ngja me te vertete, me te gjitha padrejtsite e tija jo kristjane dhe me pikllimin e tij te madh. Ketu nuk ka kurrfare genjeshtrash, kurrfare zbukurimesh as hipokrizije.

Ndigjoni njerez!

Dyzete vjete ka punue Jernej, dyzete vjete ka ndertue Jernej. Ka ndertue shtepin. Ka ngrite pasunin.

Dyzete vjete i ka lage me gjakun dhe djersën e tij fushat e veta... Dhe perendija e ka bekue punën e tij, dhe ajo ka dhane frytin njiqind, dhe njimije fish... Kur vdiq zotnija i vjeter, i biri i tij erdhi dhe i tha Jernejit: »Ti e ke krye rrogen t'ande — rrogtar. Merre bohçen t'ande te teshave dhe shko. Tash un jam ketu i vetmi zotni«.

Ndigjoni, njerez te perendis, dhe ju vet gjykoni.

Dyzete vjete ka punue sherbtori, me gjakun e tij fushat i ka lage. Shtepin e ka ndertue, pasunin e ka krijue, e tash, kur asht plake dhe e ka lane shendeti, kur nuk ka ma gjak, qe fushat t'i lagi me te, kush ka te drejte me i thane: »Rrogtar, merri teshat tua dhe shko«.

Cili asht ai urdhen i perendis, cili ligj i njeriut e ka caktue, qe Jernej mos te kete ku me ra, mbassi ka kosit aq shum sane, sa qe shtrega e saj kishte me qene ma e madhe se maja ma e nalte? Dhe qe mos t'a kete koren e bukes, mbassi i ka mbush te gjitha hambaret me grun, me theken, me buke?

Njerez te perendis! Ndigjoni dhe gjykoni vete.

E kujt asht molla, a asht e atij, i cili e ka mjelle dhe punue (kultivue), a po e atij, i cili e ka marre te pjekun nga rrenabi?

Ndigjoni dhe gjykoni!

Dykja e pare

(Nji dhome ne nji shtepi katundi, e cila ka pamjen, sikur epet dreka e permorteshme. Katundaret hyjne mbrenda. Perpara iu shkon zotnija. Ulen rreth tavolines. Mbas tyne ec dhe Jernej. Jernej asht njeri ne moshem afer 70 vjeçare, plak, i munduem nga puna, kock e lekure, i krrusun dhe i thime. Zotnija asht burr ne moshem 40 vjeçare. I majm, kryenalt, idhnak. Nga fytyra e tij shifet se ka qejf me pi).

JERNEJ: **Te gjithe do te shkojme atje; une, me duket, do te shkoj i pari mbas tij.**

ZOTNIJA: (Zemrueshem dhe nga nji naltesi): **Fole i pari, por nuk je i pari.**

JERNEJ: **Gjithmone ke qene talles dhe shakaxhi e i tille edhe do te mbesish, Zotni, por mua po me duket, se bash nuk te ka thye zija... Maskujt le te pijne, e plakat le te qajne!** (Pushim. Te gjihte habitshem i kane ngule syet ne Jernejin dhe zotnin. **Çka asht!... Pse me shiqoni ashtu e nuk folni kurrgja? A jam une midis te mijve a midis hajdutve, te cilet mendojne qe te me mashtrojne?**

ZOTNIJA: **Mos na krahaso me hajdute! Je deje ma pare se t'a kerkojsh venen.**

JERNEJ: **Nuk te ka hije ty, zotni, as juve, te dashtunit e mij, qe me çpifni per nji pike vene ne vorrim. Le t'u a bekoje perendija te gjitha, çka te hani e te pini, une nuk u a kam zili. Ne qofte se keni zaktue ndoj rend te ri, une do te bindem. Sherbe**

torit nuk i ka hije qe te prishi rregullin te cilin a ka caktue zotnija.

ZOTNIJA: **Nuk kemi nevoje per predikimet tua, Jernej!**

JERNEJ: **Çka me bane, zotni, me fjalen tande te keqe mue njerit plak? Pse me poshtnove dhe me turpnove ne kete menyre?** (Nji pushim i vogel).

Dyzete vjete kane kalue, dyzete e asnji ma pak, qysh kur e kam kalue kete prak, dhe kurr nuk me ngjau nji turp i tille! (Ngrihet ngadale nga karrika tue tregue me dore per rreth vediit). **Atehere ketu ka qene nji kasolle e vorfen dhe e mjere, nji shemtim per sherbtor dhe per zotni. Djersa ka shkue rrke, dhe na e kemi ndertue shtepin, kemi ngrite pasunin. Shtepija e jone shiqon fushen e gjane te bekueme. Kush e ka punue ate fushe, kush e ka zgjanue? Te gjithe kane vdeke, kam mbete vetem une, pendari i mbram, germihsi i mbram.** (Nji pushim i shkurte. Jernej me qetsi i drejtohet zotnis): **Ke pi rrast ne vorrin e babes! Shko dhe flej.**

ZOTNIJA: **Kend e ndjek ti qe te fleje, rrogtar? Kush asht i dejun, rrogtar?**

JERNEJ: **A thue ende nuk te ka kalue marrzija? Ende fryma e babes ndihet ne dhome; ma mire bje ne gjuj dhe lute perendin sonte.**

ZOTNIJA (me terbim): **Jernej! Ndal te them dicka. Kerko per vedi nji zotni te ri!** (Kcen nga karrika dhe me terbim i bje tavolines me grusht, bertet sa mundet). **A je shurdhue, rrogtar, une po te tham: gjeje zotnin tjeter! Te une dhe ne shtepin t'eme ti e ke krye rrogen t'ande:**

JERNEJ: **A, mire te mora vesht dhe te kuptova, djaloç'i jem! Por fol me mend, se edhe me te ndigjue te ndigjoj. — Çka don te thote kjo: ngarkoj cuklat tua ne shpine te vjeter dhe del prej shtepise?**

A ka ne keto fjale drejtesi dhe gjykim te perendis? Sikur te me kishe thane: »Jernej, je plak dhe mollse, merre çibukun dhe rri afer zjarmit«, une te kisha pergjegje: »Merri te gjitha, qe jane rrit aq per mrekulli nga gjaku i jem dhe nga djersa e eme...«

ZOTNIJA: **Njerez te perendis, shiqonije, dhe ky te murmurisi?** (Tregon deren me gisht). **Del** perjashta pa fjale !Deren e ke te hapun, prakun e ke **t'ulet . . . Perjashta!**

JERNEJ: (me qetesi). **Gostituni, te dashtunit e mij e une po shkoj. Do te kthehem me ligj te shkruem, se perendija urdhnon, ligji nuk rren. Buka te cilen e kam gatue me duer te mija, asht buka e jeme. Djersa, e cila ka pikue nga balli i jem asht djersa e jeme. Ky asht ligj. Kjo asht drejtsija.**

ZOTNIJA: **Perjashta!**

(Ndersa Jernej del ngadale, bije perdja).

(Perdja)

D u k j e e d y t e

(Ne fund te skenes asht shtri ne bar Gostaçev, ish student. I veshun me rrobe te qytetit, i parregulluem, i pa rruem, plote pluhun. Ne goje e mban cingaren. Hyn ngadale Jernej me shkop ne dore dhe me bohçen e teshave).

GOSTAÇEV: **Ku po shkon, Jernej?**

JERNEJ: (Ngrihet nga mendimet e ihella e vetem tash e shet Gostaçevin, e shikjon, disa sekunda nuk asht ne vedi).

GOSTAÇEV: **Ç'ke, Jernej, ku je nise?**

JERNEJ: (Gjithnji asht tue hehste, shikjon mendueshem Gostaçevin, e mandej me za t'ulte fare si me fole me vetvehten):

Ti, qe je njeri me shkolle, ma spjego nji gja.

GOSTAÇEV: **Çka asht ajo, Jernej?**

JERNEJ: **Para dyzete vjetesh kam ardhun nga Resja. Ne shtepi ishim teper shum, dhe une dola ne gyrbet. Moti ka qene ajo. E atehere, dyzete vjete kam punue te Sitari j vjeter** (I tregon me dore fushat per rreth tij). **Shiqoni keto fusha. Nese bjen ne gju dhe e shiqon dheun ma mire, do ta shofish punen t'eme, do ta njofish gjakun t'em.** (Nji pushim i vogel). **Ma thuej, Gostaçev, te kujat jane keto fusha?**

GOSTAÇEV: **Po, keto te gjitha i takojne Sitarit.**

JERNEJ: **Kujt? Sitarit? Ku je sjelle ti rrugash qe nuk e din? Ka vdek. Dje e kane vorrue. Kam mbete vetem une: lavruesi i mbram, germihsi j mbram, zotnija i mbram.**

GOSTAÇEV: **Çka asht ba me Sitarin e ri?**

JERNEJ: **Ktheu e shif, qe ku rrin ne kambe pa-**

ra shtepis. Zoti na ruejt, kurrgja te keqe nuk po tham per te. Kishte me qene nji puntor i mire, vetem po pin teper dhe asht i ngutshem nga natyra... por kurr nuk t'a perza nga shtepija.

GOSTAÇEV: **Si t'a perzash ti nga shtepija, kur ai asht vet trashigimtari i babes?**

JERNEJ: (Menjihere kcen, sikur te kjshte prite nji pergjegje): **Pse po flet pallavra, o dituni e shprazet. Trashigimtar dhe zotni simbas babes, ajo asht nji zakon, ndoshta dhe nji e drejte, zoti e din. Une katerdhete vjete kam punue, katerdhete vjete kam ndertue, kam ndertue shtepin, kam k r i j u e p a s u n i n. E t a s h j a m p l a k e dhe molise, ka ardhe Sitari i ri dhe me ka perzane prej shtepije. Cili ligj i ketij dheu, cila drejtsi e perendis ka thane qe mos te kem ku t'a mbeshtes koken e vjeter, qe mos t'a kem koren e bukes ne pleqni, une, qe i kam ba te gjitha, une, qe te gjitha keto i kam punue?**

GOSTAÇEV: **Jernej, keshtu e ka caktue ke'e, ligji i njeriut. Sherbtori mbaron shtepin, e kur ta mbaroje, zotnija do te ulet prane tavolines e sherbtori ne prak te deres. E urdhni i perendis thot: »Duroi te gjitha. Kur te bije ndokush faqes se djathte, shtrija edhe te majten, e kur ta marri tabaren epja edhe kmishen.**

JERNEJ: (zemrueshem, me za te nalte): **Po rren! Perendija nuk ka thane qe te bahet e padrejta.**

GOSTAÇEV: **Jernej, mos ban fjale mbi drejtesine, mbi ligjet mbi urdhnat e perendis! Une kam dashte qe t'ua spjegoj njerzve padrejtesin e botes dhe te ligjit, e me kane hjedhe ne rruge si rebel.**

JERNEJ: **T'a kane ba te padrejte, e cila ta ka plague zemren, e prandej ti nuk beson ma ne drejtsi. Por une po te them: ka drejtsi ne bote, une do ta gjej!**

P e r d j a

Dukja e trete

Dhoma e komunes. Midis skenes nji tavoline. Mbi te disa shkresa te shperndame. Prane tavolines asht ulun kryetari i komunes, i majm, simbas dukjes i pergjet zotnis. Shifet se asht pasanik.)

KRYETARI: **Çka asht Jernej? Prej kah po vjen ti?**

JERNEJ: Ndigjo, kryetar, çka due me te thane, e gjyko me te drejte dhe me ligj. Sitari i ri ka thane: «Shko, kerko per vedi nji zotni tjeter!» Keshtu ka thane, dhe aspak nuk i ka ardhe turp.

KRYETARI: **Fort e ke zgjate, ke muejt me than kete me disa fjale: »Sitari me ka perzane nga sherbimi».**

JERNEJ: Si, me ka perzane? Si, mundet te me perzaje ai mue? Kush e ka krijue me fuqin e vet te gjith ate pasuni? Une, qe kam ndejte zdeshun dhe i djersitun ne fushe, apo ai, qe ka ndejte rate ne skutina tue piskate? Une e kam krijue. Kush ka atehere te drejte qe te me thot: «Ngarkoi plaçkat tua dhe shko!» Thueje te drejten, kryetar, spjegoi ligjet.

KRYETARI: **Vertete çka kerkon ti, Jernej? Per çka ke ardhe?**

JERNEJ: **Kam ardhe me kerkue drejtsin, e jo per me te lute per buke. Shiqo ne ligje, çvulosi fletet, spjegoje drejtsin dhe te shkoj ne pune i'eme**

KRYETARI: Jernej tregoju barive se çka te ka **ngja, ne qofte se nuk don te flasish me mend. Ma**

thuej vetem kete, tjeter gja nuk po te pyes: «Çka mendon tash, Jernej, kkur nuk ke as shtepi, as zotni e ku do shkojsh?»

JERNEJ: Ku do te shkoj?

KRYETARI: Po. Sitari te ka perzane nga sherbimi, nuk ke shtepi as zotni ... Ku do te shkojsh tash?

JERNEJ: A thue ky asht ligji, a thue kjo asht drejtesija?

KRYETARI: Mos fole mbi ligjin dhe drejtesjn.... Ku mund ti dije nji sherbtor ato gjana, dhe ku i perkasin ato atij?

JERNEJ: Keshtu pra, qenka puna? A thue asht e shkrueme ne ligj: «Per sherbtorin nuk ka as drejtsi, as ligj?

KRYETARI: Nuk thash ashtu, as nuk asht e shkrueme n'asnji vend ashtu, mos i ndrysho fjalet e mija. Zotnija asht zotni, e sherbtori asht sherbtor. Ne qofte se i thot zotnija: »Mbledhi plaçkat tua, dhe çou e shko» — sherbtorit i duhet qe te çohet dhe te shkoje rruges se vet.

JERNEJ: E kjo asht drejtesi?

KRYETARI: Kjo asht drejtesi.

JERNEJ: Vetem edhe kete m'a spjego, kryetar. Si mund t'a mbeshtjelli ne bohçem e teshave punen t'eme, si mund t'a fus ne te mundin dyzetvjeçar, kete ma spjego, e atehere po shkoj.

KRYETARI: A ke ardhe ti ketu qe te tallesh? As bretkocat nuk kishin me i ndigjue ma fjalet e tua.

JERNEJ: Deri dje, ndryshekane kumbue fjalet e tua, kryetar. Çka te kam ba qe te me peshtysh ne fytyre?

KRYETARI: Nuk t'a kam borxh as biseden as pergjigjen, sherbtor! Me len ne qetsi mue dhe komunen. E shko kah te dijsh vet. Perjashta.

JERNEJ: (I drejtohet publikut, afrohet me hapa te ngadalshem): **Ndigjoni, ndjgjoni tash, njerez te perendis, dhe gjykoni vet! Po e pyes ndergjegjen t'uej, mos u-ngutni me pergjegje. Te gjithe me njifni. Shum jeni ba burra e keni qene djalosha dhe femije, athere kur une korrsha dhe kositsha. Shtepija e jeme ka qene aty, fushat e mija kane qene te lavrueme derj sa ju nuk keni pase shtepi as ne barkun e nanave t'ueja. Dyzete vjete kane kalue qysh atehere. Tash te gjitha jane te punueme, te kosituna dhe te mbledhuna ... e tash, Jernej, kur i ke krye te gjitha, ngarkoj plaçkat tua ne shpine dhe del! Keshtu ka ngja — Banu, gjykatesa, njerez, mendoni dhe gjykoni.**

(P e r d j a)

(Skena hapet vetem 2 metra. Shifet Jernej tue iu lute perendis).

JERNEJ: **Ati i yne, qe je ne qiell ... kerkoj drejtesin t'ande, te cilen e ke dergue ne bote. Je i drejte pa kufi, epja puntorit rrogen e tij! Shperbleje sherbtorin, i cili ka uri dhe etje per drejtesi! Merr parasysh urine e tij, shueje etjen e tij . . . . .**

Ati i yne qe je ne qiel... mos e shti ne prove kryetarin, dhe as sherbtorin t'and mos e provo teper, sepse tash asht plak dhe molise. Ati i yne qe je ne qill... ne qofte se ndonji here e kam ofendue ndonjenin nga ju, kedo ne mes t'uej, qe endeni botes poshte e perpjete pa shtepi as konak, mos u zemroni ne mue dhe mos me kujtoni me kujtim te keq. Ju rrugtare te lodheshem, qe ju ka lodh drejtesija, ma teper se rruga e repjete, ne qofte se ndo'i here e kam perzane kend prej shtepije, mos me nemni ne zemren t'uej.

(P e r d j a)

Dukje e kaferte

(Skena e njajte si ajo ne dukjen e dyte. Gostaçev asht shtrimun ne bar. Vjen Jernej).

GOSTAÇEV: **Si po e ndien vehten, Jernej, me shkop t'udhtarit?**

JERNEJ: **Perendija e din, se pse ma ka ngarkue barren. Kush guxon te baje fjale me te?**

GOSTAÇEV: **Perendija ka pase ma shum meshire ndaj meje se ndaj teje, Jernej! Mue ma ka zbulue padrejtesin qysh ne fjllim, e ty ne mbarim. Une kam jetue ne mendim te gabueshem vetem nji gjysem ore, e ti plote dyzete vjete. Mue me ka qite ne rrugen e mesimit te vertete, pa ndonji ceremoni te pasaçme e ti plote dyzete vjete ke shkue rruges se shtrembet, keshtu edhe kthimi do te jete i gjate, - Jernej: Shiqo, Jernej, porsa kam fjllue me pa, me njihere kafe fillue te me rrafin me dru te çame, mue, femin e pafuqishem. Kahdo qe kam levize e ramja me ka percjelle si pershendetje. Thell, Jernej, thell ma kane ngule ne koke mesimin e vertete, thellsisht e kam kuptue ligjin dhe urdhenin, se drejtsjja asht krijue per ata qe e kane krijue. Pasunija ma e madhe asht ditunija, edhe ne qofte se kjo futet ne koke me ane te drunit te çame. — Po ti, Jernej, çka e ke menden me ba tash?**

JERNEJ: **Gjyqtarve te drejte do t'iu drejtohem une. Qysh neser ne mengjes heret do te nisem per 'ta.**

GOSTAÇEV: M'a thuej vetem edhe kete: »Ku do t'i gjejsh gjytare te drejte?«

JERNEJ: Do te shkoj te ata te cilet jane te ftuem qe te gjykojne me te drejte dhe me ljgje. Perendija e ka dergue drejtesin ne bote dhe nuk lejon qe njerzit t'a mbyllin n'arke.

GOSTAÇEV: I forte asht besimi i yt, e i madh do te jete mkati qe do t'a bajne ata ndaj teje.

(P e r d j a)

Dukje e peste

(Salla e gjyqit, e midis tavolines nji kryq. Djathtas dhe majtas nga kryqi qirat. Mbi tavoline libra te trashe te paluem. Prane tavolines gjykatsi, me rrobe elegante, si njeri i saloniit. Ngadale hyn Jernej dhe ndalohet para tavolines se gjykatsit.)

GJYKATSI: **Kush je ti, o njeri, dhe ke e kerkon?**

JERNEJ: **Une jam Jernej nga Betajnova. M'a kane ba nji padrejtsi. Kam dale neper bote me kerkue te drejten, te cilen e ka dergue perendija, dhe te cilen e ruejne gjyqtaret ne librat e tyne.**

GJYKATSI: **Ç'padrejtesi te kane ba, ke e padit, dhe pse?**

JERNEJ: **Askend nuk padis, sepse nuk due qe ata njerez te vuejne per shkak te drejtes s'ame. Keshtu ka qene puna: Dyzete vjete kam punue te Sitari, e kam krijue pasunin, kam ndertue shtepin. Por, Sitari i vjeter ka vdeke, e i biri, axhami, erdh e tha: «Jernej, lidhi, çka ke dhe shko. Tash jam une zotni. Merre shkopin t'and te rrugtarit dhe shko, kah te çojne kambet. «Keshtu ka thane. Keshtu edhe perfaqsuesi i drejtesis ka thane dhe vertetue, se molla i takon atij, i cili e ka marre te pjekun prej gjembit, e jo atij qe e ka mbjelle dhe kultivue mollen. Une e kam marre boten per t'a kerkue te drejten, te cilen e ka dergue perendija, dhe te cilen nuk mund t'a asgjefuqija e njeriut. Tash gjykoni.**

GJYKATSI: (gjysem ne tallje e gjysem me ironi): **Kthe**

huni ju mbrapa tek zotnija i juej i cili asht zemer gu-ri dhe i padrejte, dhe thueni: »Respektoje drejtesin dhe kij meshihre, epma nji cope buke ne pelqni.« Thueni keshtu, e atij do t'i vije keq do t'a shofi mkatin e tij, dhe do te baje çka t'a lutni ju.

JERNEJ (ashper): **A jeni ju gjykates?**

GJYKATSI: **Po, jam.**

JERNEJ: **Dhe e gjykuet simbas se drejtes se shkrueme te perendis?**

GJYKATSI: **Ashtu e kam gjykue.**

JERNEJ: **Une po ju tham, se jo. Hapni librat t'uej. Me lexue me te vertete nuk dij, por asht e shkrueme; Ke punue dyzete vjete. me gjakun t'and i ke lage fushat, e tash, kur je plak dhe ke mbete pa fuqi, kur tashma nuk ke gjak, qe t'i lagish fushat me te, tash ik! Kete m'a thueni dhe ma spjegoni, çka te baj tash me punen t'eme? E gjith puna e jeme asht mbulue me dhe, si t'a zbuloj tash? Dyzete vjete, numroni, sa dite jane ato, sa ore jane .... Me kallxoni, a asht ne gjendje kjo bohçe teshash t'i mbledhi te gjitha ato jave dhe te gjitha ato dite?**

GJYKATSI: **Kondendohuni me drejtsi, sido qe te jete ajo, njerzit e kane krijue, ia kane dhane forcen dhe fuqin. Ne qofte se ajo asht aq e deformueme sa qe mos te mund t'a dalloje njeriu nga anmiku, kthehuni anash dhe mos bani pazarllek me gjykatsin.**

JERNEJ: **Pra, nuk paska drejtsi?! Ose ju e keni meshef? Prandaj ju e keni mbylle ne kete shtepi te madhe, qe mos te mund te dali ne bote, dhe mos te takohet me Jernejin. Por vet jeni mashtrue. Nuk e keni njofte Jernejin.** (Gjykatsi ban me dore dhe del perjashta). **— Do t'a kerkoj, edhe sikur te jete fute ne dhe aq thelle, si jane fute puna dhe mundi i em.**

(Perdja)

(Skena hapet vetem per 2 metra. Shifet Jernej tue iu lute perendis.)

JERNEJ: **Praj, ma, o perendi, jam plake dhe lodhe. Vet e ke caktue masen e vuejtjeve dhe te pesimeve. E ke caktue simbas fuqis s'eme dhe nuk je mashtrue. Vetem edhe nji pash matma, e kurrgja tjeter.Ban qe per se shpejti t'i ndigjoj fjalet e tua, qe te pushoj per se shpejti. Duert me dridhen, vesht jane tue me lane, edhe me pa shof dobet nga idhnimi teper i madh. Ngushlloje ma ne fund sherbtorin t'and Jernej qe me zemer te çelun dhe te gezueshme te da le para teje, e ndaj atyne, te cilet enden rrugeve dhe peshtyjne ne drejtesin t'ande, kij meshire dhe ndrıçoi mendet e tyne!**

(Perdja)

Dukja e gjashte

(Zyra e nenpunsit mbretnor. Nji tavoline shkrimi, e prane saje nji zotni ne kohe, me jake te gjane e te ngrime. I shtangun, byrokrat tipik).

NENPUNSI: (me nervozitet, terbueshem, dhe me nençmim): **Prej kah vjen ti? Nga je ti? C'kerkon ketu? Kallxo shpejt dhe mos fole shum...**

JERNEJ (me aetsi dhe pervujtni): **Ju pershendes. zotni. I pershendes edhe fjalet tua, sado qe te pakandeshme te jene ato. Une jam Jernej nga Betajnova. Kam dale me kerkue drejtesin dhe keshtu kam mbrri ketu. Njerzit nuk m'a kane dhane, gjykatsit nuk ma kane dhane....**

NEPUNSI: (kthehet dhe shkon).

JERNEJ: Si, zotni? Ende as nuk me keni ndigjue deri ne fund, ende nuk e keni ndigjue lutjen t'eme! Çomeni atje, ku mbretnon drejtsija!

NEPUNSI: **Do te dergojme na ty atje ku mbretnon mendja dhe drejtesija.** (Fishkullon, policija hyn befas ne skene).

JERNEJ: **Ku po me çoni, njerzet e perendis?** (Policet e mbretit e ngrehin Jernejin perjashta). **Ku po me çoni, o, njerez....?**

NEPUNSI: **Ne vendlindjen t'ande, ne Resje!**

JERNEJ: **Pse ne Resje, atje nuk asht vendi i jem. atje nuk kam askend.** (Policija e ngreh perjashta).

(Perdja)

Dukje e shtate

(Dhoma e prifti. Askush nuk asht ne te. Jernej hyn ngadale, e shef mbi mur figuren (fotografin), ban kryq dhe i lutet perendis. Ai asht plote pluhun dhe i shkyem teshash, bie ne gjuj).

JERNEJ: **Si ke thane, bane tash. Drejtesin ua ke dhane njerzve, ata e kane meshefe, nuk ekziston as tek shkruesi, as tek gjykatsi, as te mbreti. Shkrojsit me kane shti ne mes te kriminelave, gjykatsit me** kane vu ne tallje, tek mbreti me kane mashtrue. Te **ti asht drejtesija ti e ke dergue. Ti kujdesohu per te, qe te kryhet urdhni i yt. Vetem ty te drejtohem une, sherbtori Jernej. Fjalen t'ande e kam ndigjue, qe mos te humbi shpresen dhe besimin ne ty. Tash shtrije doren t'ande, o zot i gjithfuqishem, jij i drejt.**

(Hyn ngadale prifti, nuk e njef me njihere Jernejin dhe i afrohet ma afer. Jerneji kthehet kah prifti.)

PRIFTI: **O, Jernej, Jernej, kah je sjelle, qe je plake dhe dobsue aq teper?**

JERNEJ: **Jam sjelle botes. Prej shkruesit deri te gjykatsi. Prej gjykatsit deri te mbreti. Drejtsi nuk paska nen qiell. Une nuk e kerkoj ma mbi dhe. Shkrojsit dhe gjykatsit e kan mohue perendin, e kane trathtue u - dhnin e tij. Nga perendija kerkoj drejtsin, hape librin, ju sherbtor i tij, gjykoni te drejten t'eme simbas drejtsis se tij.**

PRIFTI: **Mos ashtu, Jernej. Shum te kqija i kane ba, jane sjelle me ty ne menyre jo kristijane. Faljau**

fajin, ashtu si iu a ka fale perendija atyne, te cilet e kane ndjeke.

JERNEJ (me ashpersi dhe za te nalte): **Nuk jam tue fole mbi meshiren dhe faljen. Mbi drejtesin jam tue fole. A asht perendija n'anen t'eme, a po n'anen e gjykatsit dhe shkruesit te padrejte? Kete gjykoni.**

PRIFTI: **Te mbrapshta dhe te padrejta jane mendimet tua, Jernej.**

JERNEJ (me za te plote dhe fort kjarte): **Gjykoni!**

PRIFTI: **Nenshtrou, Jernej! Nenshtroju padrejtsis, se perendija do te gjykoje.**

JERNEJ: **Ai asht i drejte pakufi, por ku asht drejtesija e tij?** (Tregon me gisht per dritare.) **A asht kjo shtepija e jeme a po nuk asht? Kete ma thueni.**

PRIFTI: **Fjalet tua e fyejne perendin, Jernej. Kur te dalish para perendis, mos kerko, por bje ne gjuj, lute dhe qaj.**

JERNEJ: **Nuk due te lus dhe nuk due te qaj! Drejtesija e jeme asht dhe drejtesi e perendis. Keshtu ai e ka caktue, kete ai nuk do t'a shkeli. Ate cka ka thane, ai nuk do t'a mohoje.** (Me za ma te nalte) **Mue ai me ka borxh, dhe prandej nuk bije ne gjuj, por qendroj ne kambe dhe kerkoj! Gjykoni!**

PRIFTI: **Perjashta, i pafe! Perjashta i pazot!**

JERNEJ (i drejtohet publikut): **Nuk ka drejtesi ne bote!**

(Perdja)

Dukje e fundit

PERSONI NE FUND TE SKENES:

E pate kete tregim ashtu si ka ngja ai me te vertete, pa kurrfare hipokrizije e zbukurimi. Ndigjoni njerez! Dyzete vjete ka punue Jernej, dyzete vjete ka ndertue Jernej, e kur asht plake dhe molise, kur nuk ka pase ma gjak, qe t'i lagi fushat me te, i tha, zotnija: »Ti e ke krye rrogen t'ande, rrogtar. Shko!» O njerez, ndigjoni dhe vet gjykoni! A thue k e s h t u e ka caktue drejtesija e perendis? Nuk e ka caktue keshtu. Perendija ka thane: Buka, qe e ke gatue, asht buka e jote, dhe gjaku, qe e ke derdhe, asht gjaku i yt.Keshtu ka thane perendija, dhe keshtu asht e drejte. Sepse perendija nuk genjen.

(Skena, e cila deri tash ka qene ne terr, keshtu qe personi vetem sa u dallonte, dal-ngadale ndriçohet. Kur te zdritet plotesisht, e shofim — kuvendarin, nji djaloç te veshun ne kostum t'asaj krahine, ku luhet pjesa. Pa kurrfare spitullimi, krejte natyral, i afrohet cepit te skenes dhe kthehet kah publiku).

E pate kete tregim mbi sherbetorin Jernej dhe te drejten e tij. E pate edhe ate, se prej kujt e ka kerkue drejtesine! Ai ate nuk e gjeti! — Pse Jerneji nuk e gjeti drejtesine? Ai iu asht drejtue atyne te cilet siç e thote vet Jernej — e kane mbylle me nande vula dhe e kane shti njiqind pash thelle ne dhe. I dobet ka qene Jernej, i dobet asht nji njeri, qe t'i theje ato nande vula, qe te depertoje njiqind pash thelle ne

mbrendine e tokes. Te forta jane vulat, ato jane zinxhiret, me te cilet e kane lidhe drejtesine. E pafuqishme asht drejtesija e nji njeriut, qe t'i kepusi zinxhiret, qe t'i zhgatroje muret e burgut. Jo nji, te gjithe se bashku! Vetem ne kete menyre mund te keputen zinxhiret! Vetem ne kete menyre burgjet mund te rrenohen! Vetem keshtu mund t'a shlirojme drejtesine!

Ka gabue Jerneji i vjeter kur ka thane, qe nuk ka drejtesi. Drejtesi nuk ka tek ata, ke te cilet e ka kerkue ai. Ata e kane lidhe ne hekura, ata e kane burgose. Por, drejtesi ka e, ne qofte se asht e lidhun me zinxhir, ne qofte se asht e burgosun, duhet me e shlirue!

(F U N D)